




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova**  
**Republic of Kosovo**



**Komuna e Gjilanit**  
**Opština Gnjilane**  
**Municipal Gjilan**  
**Gilan Belediyesi**

## **DREJTORIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT**

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr.: 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, dhe në Rregulloren së Komunës së Gjilanit për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve Nr.016-126422, dt.29.12.2016, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport-Gjilan shpall:

**Thirrjen për aplikim në Programin Vjetor të Galerisë së Arteve- Gjilan, për vitin 2025**

## **Udhëzimet për Aplikantët**

**Data e hapjes së thirrjes: 20.11.2024**  
**Afati i fundit për aplikim: 11.12.2024**

Nëntor, 2024

## Përmbajtja

1. Hyrje .....	2
2. Si të aplikoni .....	2
2.1 Dokumentacioni i detyrueshëm për OJQ .....	2
2.2 Dokumentacioni i detyrueshëm për Individë .....	3
2.3 Ku ta dorëzoni aplikacionin .....	4
2.4 Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve .....	4
2.5 Aktivitetet e pranueshme që do financohen përmes thirrjes publike.....	4
2.6 Aktivitetet e pa pranueshme që nuk financohen përmes thirrjes publike.....	4
2.7 Shpenzimet e drejtëpërdrejta të pranueshme përmes thirrjes publike.....	5
2.8 Shpenzimet e pa pranueshme.....	5
3. Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi.....	6
4. Kalendari tregues.....	7
5. Lista e dokumenteve të thirrjes publike.....	7&8

## 1. Hyrje

Rregullorja për Kriteret Standardet dhe Procedurat e financimit publik për OJQ-të në Nenin 14 ka paraparë edhe përgatitjen e udhëzimeve të thirrjes për Aplikantët për paraqitjen e informacionit mbi objektivat e thirrjes publike, kushtet e thirrjes, mënyrën e aplikimit dhe zbatimit të procedurës së thirrjes dhe përzgjedhjes së përfituesve. Udhëzimet për aplikuesit kanë për qëllim të japin një pasqyrë të plotë të qëllimit të hapjes së thirrjes publike. Aplikuesi duhet të analizojë në mënyrë të plotë thirrjen publike dhe këtë udhëzim për aplikim për të krijuar një pasqyrë mbi qëllimin e ofruesit të mbështetjes financiare me rastin e hapjes së thirrjes publike.

Sa i përket procesit të pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënies së fondeve, kohës dhe mënyrës së parashtrimit të ankesave, trajtimit të dokumenteve dhe kalendarit tregues të zbatimit të thirrjes, lexoni udhëzimet këtu: Rregullore MF – Nr. - 04/2017 Mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik te OJQ-ve

## 2. Si të aplikoni?

Aplikimi i OJQ-ve dhe Individëve konsiderohet i plotë, nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në paragrafin 2.1 përkatësisht 2.2 dhe dorëzohen siç kërkohet në paragrafin 2.3 nga ky udhëzim.

### 2.1 Dokumentacioni i detyrueshëm për OJQ

1. Çertifikata e regjistrimit të OJQ-së;

2. Çertifikata e Nr. Fiskal të OJQ-së;
3. Vërtetimi/ konfirmimi bankar i OJQ-së;
4. Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit të OJQ-së;
5. Aplikacioni për projekt;
6. Forma e buxhetit;
7. Deklarata mbi financimin e dyfishtë për OJQ;
8. Deklarata e partneritetit për OJQ;
9. Deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin paraprak;

## **2.2 Dokumentacioni i detyrueshëm për Individë**

1. Aplikacioni për projekt;
2. Kopja e letërnjoftimit;
3. Certifikatë e vendbanimit;
4. Konfirmimin nga banka për xhirollogarinë e aplikuesit;
5. Dëshmi se nuk ka obligime ndaj ATK-së;
6. Forma e buxhetit;

***Shkarko, dhe plotëso me kompjuter, dokumentacionin (Aplikacioni për projekt, forma e buxhetit, deklarata mbi financimin e dyfishtë, deklarata e partneritetit, deklaratë mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në vitin paraprak ) të cilat janë publikuar në kuadër të kësaj thirrje.***

### **2.3 Ku ta dorëzoni dokumentacionin:**

- Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Për individët, kërkohet vetëm nënshkrimi.
- Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen personalisht, në kopje fizike, në adresën e mëposhtme:
- Aplikimi origjinal, duhet të dorëzohet në Qendrën për shërbime me qytetarë, ndërtesa e Soliterit, kati I. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet emri i aplikuesit me shënimin: *“Të mos hapet para takimit të Komisionit Vlerësues”*.

### **2.4 Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve**

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga data: 20.11.2024 deri më 11.12.2024.

#### **VËREJTJE:**

- Nuk pranohen punimet fizike (piktura, skulptura, etj.)
- Numri i punimeve që do të ekspozohen vendoset nga GAGJ-së.
- Brendimi/Dizajni paraqitës, negociohet me GAGJ.

### **2.5 Aktivitetet e pranueshme që do financohen përmes thirjes publike**

Aktivitetet e pranueshme të projektit mund të përfshijnë:

1. Kërkesat nga OJQ-të të profilizuara në fushën e kulturës;
2. Kërkesat nga Individët (Artistët dhe Kuratorët).

### **2.6 Aktivitetet e pa pranueshme që nuk financohen përmes thirjes publike**

1. Aktivitete që përmbajnë diskriminim gjinor;
2. Aktivitete që përmbajnë diskriminim fetar;
3. Aktivitetet të cilat përmbajnë promovim të gjuhës së urrejtjes;
4. Aktivitetet të cilat përmbajnë nxitje të ekstremizmit të dhunshëm.

## **2.7 Shpenzimet e drejtëpërdrejta të pranueshme përmes thirrjes publike**

Shpenzimet sipas kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë direkt të lidhura me zbatimin e aktiviteteve të projektit ose të programit të propozuar, të tilla si:

1. Shpenzimet rreth organizimit të aktiviteteve;
2. Material shpenzues;
3. Sigurimi i sallave, shpenzimet e zërimit, ndriçimit;
4. Transporti
5. Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit),
6. Shërbime grafike (shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, duke specifikuar llojin e qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj.)
7. Kosto të tjera që lidhen drejtëpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit.
8. Pagat

## **2.8 Shpenzimet e pa pranueshme**

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

1. Renovime;
2. Dhurata;
3. Shpenzime për blerje të paisjeve;
4. Shpenzime për kompensime të ndonjë borgji paraprak;

### **3. Dokumentacioni shtesë dhe kontraktimi**

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni, DKRS-ja do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, kanë hyrë në listën e përkohshme të projekteve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, DKRS-ja do të kërkojë shqyrtimin e vijave buxhetore për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara. Linjat buxhetore duhet të nënshkruhen nga përfituesi i projektit dhe zyrtari përgjegjës në DKRS.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse përfituesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së caktuar, përfituesi do të refuzohet.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët, aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar në lidhje me vendimin për financimin e projekteve.

#### **4. Kalendari tregues**

Fazat e procedurës së thirrjes:

- Afati i fundit për aplikimet : 11.12.2024, në ora 16:00.
- Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen : 4.12.2024 në ora 16:00.
- Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen : 4.12.2024, në ora 16:00.
- Afati i fundit për vlerësimin e aplikimeve në mënyrë përmbajtësore: 25.12.2024, në ora 16:00.
- Afati i fundit për kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë: 20.12.2024, në ora 16:00.
- Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar: 23.12.2024, në ora 16:00.
- Afati i fundit për dorëzimin e ankesave: 6.01.2025, në ora 16:00.
- Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi aplikantëve: 15.01.2025, në ora 16:00.

*Financuesi ka të drejtë të përditësoj kalendarin indikativ. Duhet të dini se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në web faqen: <https://kk.rks-gov.net/gjilan/>*

#### **6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE**

##### **FORMULARËT**

1. Thirrje publike per mbeshtetje financiare per individ dhe OJQ
2. Udhezimet per aplikantet per mbeshtetje financiare per individ dhe OJQ
3. Formulari 5 Aplikacion për projekt per Individ;
4. Formulari 5A Aplikacion për projekt per OJQ
5. Formulari 6, forma e buxhetit për OJQ, Individë;
6. Formulari 7, deklarata mbi financimin e dyfishtë
7. Formulari 8, deklarata e partneritetit;
8. Formulari 9, deklarata mbi projektet e financuara nga burimet publike të financimit në dy vitet e fundit
9. Kalendari vjetor i Aktiviteteve te Galerisë së Arteve-DKRS 2024



**Vërejtje/Kujdes:** Të gjitha aplikimet të cilat nuk do të kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh dhe do të diskualifikohen në fazën I- Vlerësimi administrativ.  
-Nuk do përkrahen OJQ-të, Artistët apo Kuratorët të cilët kanë qenë pjesë e programit(përfitues) të Galerisë së Arteve gjatë vitit 2024.

Drejtori  
Kushtrim Zeqiri

